



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I MONUMENTEVE TE KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

---

Nr. 5 prot

Tiranë më 23.04.2005

**VENDIM**

Nr. 4 Dt. 21.04.2005

**PËR**

**MIRATIMIN E TESTIMIT TË PERSONAVE FIZIKE, QË  
KANË BËRË KËRKESË PËR MARRJEN E LEJES PËR  
RESTAURIM VEPRASH ARKTITEKTURE.**

Në mbështetje të Ligjit 9048, dt. 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore", neni 17, si edhe të vendimit nr. 9 të KKR, dt. 14.06.2004, "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave administrative për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të restauratorit në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe leje të shoqërive të ndërtimit për restaurim veprash arti e arkitekture, KKR, shqyrtoi dokumentacionin e personave fizike, që kanë paraqitur kërkesë për t'u paisur me leje për restaurim veprash arti e arkitekture, mbështetur në dokumentacionin bashkëngjitur këtij vendimi, konstatoi se:

1.- Në testim u paraqitën dokumenta nga personat fizik te mëposhtem:

- Prof. Dr. Hasan Nallbani. (restaurator veprash arti)
- Arkitekt Reshat Gega. (restaurator arkitekture)

2. – Pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit rezultoi se:  
plotësojnë kriteret personat fizik te mëposhtëm:

- Prof. Dr. Hasan Nallbani. (restaurator veprash arti)
- Arkitekt Reshat Gega.

Për këtë arsye këshilli Kombëtar i Restaurimeve,

**VENDOSI :**

**Të paisë me leje për restaurim veprash arti e arkitekturore, personat fizike te mëposhtëme:**

- **Prof. Dr. Hasan Nallbani.**(restaurator veprash arti )
- **Arkitekt Reëhat Gega** (restaurator arkitekture )

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**BLENDI KLOSI**

**KRYETAR**

**SEKRETARE**

**Edlira CAUSHI**